

**VENDIM
PËR**

**KRIJIMIN E FONDIT NË MBËSHTETJE TË NDËRMARRJEVE SOCIALE DHE
FORMAT E MBËSHTETJES NËPËRMJET SUBVENCIONIT PËR NDËRMARRJET
SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr.65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Fondit në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale, me vlerë të përgjithshme 249 760 000 (dyqind e dyzet e nëntë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për periudhën 2019-2021.
2. Vlera e fondit për vitin e parë të jetë 61 600 000 (gjashtëdhjetë e një milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për vitin e dytë, 82 920 000 (tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e njëzet mijë) lekë dhe për vitin e tretë, 105 240 000 (njëqind e pesë milionë e dyqind e dyzet mijë) lekë.
3. Fondi në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale subvencionon:
 - a) veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale;
 - b) vendet e reja të punës të krijuara për punësimin e individëve nga grupet e pafavorizuara;
 - c) sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara.
4. Fondi në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale të shpërndahet, si më poshtë vijon:
 - a) 135 000 000 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë) lekë për subvencionimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale;
 - b) 37 000 000 (tridhjetë e shtatë milionë) lekë për krijimin e vendeve të reja të punës;
 - c) 7 776 000 (shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara.
5. Fondi në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale financohet nga:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) burime të tjera financimi (donatorë, institucione financiare ndërkombëtare etj.).
6. Fondi ka për qëllim mbështetjen e subjektit që i është njohur statusi i ndërmarrjeve sociale.
7. Nga Fondi në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale përfitojnë ndërmarrjet sociale që paraqesin një projektpropozim ose plan biznesi, duke demonstruar se zërat e parashikuar për mbështetje janë të rëndësishëm për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së tyre.
8. Subvencionim për zhvillimin e veprimtarisë përfitojnë ndërmarrjet sociale që paraqesin një plan biznesi, i cili justifikon arritjen e objektivave të synuar. Fondi mbulon deri në 70% (shtatëdhjetë për qind) të kostove të pranuar, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e

pesëqind mijë) lekë, në rast se subjekti është në gjendje të financojë pjesën e mbetur të investimit.

9. Në kostot e pranuar, sipas pikës 8, të këtij vendimi, përfshihen kostot:

- a) për investime në makineri dhe pajisje për realizimin e prodhimit/shërbimit;
- b) për kualifikimin dhe trajnimin për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara;
- c) për mbulimin, deri në 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës minimale, për punonjësit e rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, për një periudhë gjashtëmuajore.

10. Për të përfituar subvencione për zhvillimin e veprimtarisë, një ndërmarrje sociale duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) t'i jetë njohur statusi i ndërmarrjes sociale me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;
- b) të ketë një plan biznesi ose një projekt dhe të jetë e aftë për zbatimin e plotë dhe në kohë të veprimtarive/aktiviteteve të propozuara;
- c) Të punësojë minimalisht 3 (tre) punonjës të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga momenti i përfitimit të subvencionit për zhvillimin e veprimtarisë në ndërmarrjen sociale.

11. Pagesa e subvencionit të përfituar, sipas përcaktimeve të pikës 8, të këtij vendimi, bëhet 70% (shtatëdhjetë për qind) me miratimin e aplikimit dhe 30% (tridhjetë për qind) në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave, e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera. Një ndërmarrje sociale, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së saj, përfiton vetëm një herë subvencionin, sipas përcaktimeve të pikës 8, të këtij vendimi.

12. Subvencione për krijimin e vendeve të reja të punës përfitojnë ato ndërmarrje sociale që paraqesin propozime, të cilat reflektojnë rritjen e numrit të të punësuarve me përfaqësues nga grupet e pafavorizuara dhe kanë nevojë për fonde që mbulojnë pjesërisht kostot e krijimit të vendit të ri të punës. Për çdo vend të ri pune, ndërmarrjet mund të përfitojnë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, të cilat duhet të përdoren për mjete pune, lëndë të parë dhe materiale konsumi. Dhënia e subvencionit kushtëzohet me punësimin e personave nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara dhe kohëzgjatja e kontratës të jetë jo më pak se dy vjet.

13. Pagesa e subvencionit të përfituar, sipas përcaktimeve të pikës 12, të këtij vendimi, bëhet 50% (pesëdhjetë për qind) me miratimin e aplikimit dhe 50% (pesëdhjetë për qind) pas realizimit të shpenzimeve, kundrejt faturave të paraqitura, të cilat vërtetojnë shpenzimet e kryera. Një ndërmarrje sociale mund të përfitojë për hapjen e deri 20 (njëzet) vendeve të reja të punës.

14. Ndërmarrjet sociale, të cilat punësojnë persona nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, mund të përfitojnë subvencione të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore. Ndërmarrja sociale mund të përfitojë një financim vjetor në masën deri në 100% (njëqind për qind) të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit dhe punëmarrësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se dy vjet. Ky financim bëhet drejtpërdrejt në degën e sigurimeve shoqërore, sipas procedurave përkatëse.

15. Ndërmarrjet sociale, që aplikojnë për subvencione të formave të ndryshme të përcaktuara në këtë vendim, nuk duhet të kenë shkelur legjislacionin e punës dhe atë tatimor lidhur me detyrimet ndaj punëmarrësve, për aq kohë sa kryejnë veprimtarinë.

16. Subvencionimi i ndërmarrjeve sociale, në një nga format e përcaktuara në këtë vendim, nuk kushtëzon të drejtën e tyre për të përfituar nga forma të tjera të mbështetjes nëpërmjet:

- Fondit Social;
- Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanatit);
- Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë;
- Fondit të Sipërmarrjes Turistike;
- Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Fondit në Mbështetje të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike;
- Fondeve të tjera që mbështesin e financojnë ndërmarrjet sociale dhe fushat e veprimtarisë së tyre;
- Programet e nxitjes së punësimit për kategoritë e grupeve të pafavorizuara.

17. Vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje sociale, e siguruar nga format e mbështetjes nga buxheti i shtetit, të përcaktuara në pikat 4 e 16, të këtij vendimi, nuk do të kalojë shumën 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë për një periudhë prej tre vjetësh.

18. Ndërmarrjet sociale, që aplikojnë për ndonjë nga format e subvencionimit, duhet që, së bashku me kërkesën dhe projektpropozimin, të paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin si organizatë jofitimprurëse;
- b) Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);
- c) Vërtetimin për shlyerjen e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që lëshohen nga organi tatimor përkatës;
- ç) Numrin e llogarisë bankare;
- d) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku organizata jofitimprurëse ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për aq kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit;
- dh) Informacionin për:

- i) numrin e të punësuarve;
- ii) llojin e veprimtarisë që kryen;
- iii) nivelin e pagës së dhënë për çdo person;
- iv) akte të inspektimit, nëse ka;
- v) forma të tjera të mbështetjes së siguruar nga shteti;

19. Ministri përgjegjës për çështjet sociale ngre komisionin vlerësues të aplikimeve të ndërmarrjeve sociale për përfitimin e subvencioneve dhe përcakton përbërjen, rregullat e organizimit dhe të funksionimit të tij.

20. Ndërmarrjet sociale që përfitojnë subvencione raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale lidhur me përdorimin e subvencionit të përfituar. Afatet dhe format e raportimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

21. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë për çështjet sociale, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim.

22. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të nxjerrë udhëzimin për kriteret e dhënies dhe mekanizmin e monitorimit të ndihmës shtetërore, si dhe parashikimin e sanksioneve, në rast të mospërbushjes së kërkesave e detyrimeve nga ndërmarrjet sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I
E D I R A M A